

Drejtoria e Projekteve në Fushën e Drejtësisë

Drejtoria e Projekteve në Fushën e Drejtësisë është struktura përgjegjëse për realizimin e detyrave si më poshtë vijon:

1. Programimit dhe negocimit të projekteve të financuara nga Bashkimi Evropian në kuadër të instrumentit të Para-Aderimit (IPA);
2. Zbatimit dhe raportimit të projekteve të zbatuara në kuadër të IPA-s;
3. Përgatitjes së projekteve të mbështetura nga donatorë të tjerë;
4. Zbatimit dhe raportimit të projekteve të mbështetura nga donatorë të tjerë;
5. Koordinimit të donatorëve dhe marrëdhëniet me institucionet e tjera;
6. Hartëzimit të donatorëve dhe projekteve.

Detyrat e sipërpërmendura Drejtoria e Projekteve në Fushën e Drejtësisë, i realizon në koordinim me:

- institucionet në varësi të Ministrisë së Drejtësisë:
 1. Drejtoria e Përgjithshme Burgjeve;
 2. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës;
 3. Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit;
 4. Instituti i Mjekësisë Ligjore;
 5. Qendra e Parandalimit të Krimeve të Miturve dhe të Rinjve
 6. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas;
 7. Drejtoria e Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve;
 8. Agjensia Kombetare e Falimentimit;
 9. Qendra e Botimeve Zyrtare;
 10. Komiteti Shqiptar i Birësimeve;
 11. Agjencia e Trajtimit të Pronave;
 12. Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor.
- institucionet e pavarura të sistemit të drejtësisë:
 1. Shkolla e Magjistraturës;
 2. Kolegji i Posacëm i Apelit;
 3. Gjykatë e Lartë;
 4. Këshilli i Lartë Gjyqësor;
 5. Inspektori i Lartë i Drejtësisë;
 6. Prokurori e Përgjithshme;
 7. Këshilli i Lartë i Prokurorisë;

Instrumenti i Para-Anëtarësimit (IPA)

Instrumenti i Para-Anëtarësimit (IPA) është një instrument financiar i krijuar nga Bashkimi Evropian për t'i ofruar ndihmë Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë, si mbështetje për procesin e anëtarësimit të këtyre vendeve në familjen evropiane.

Kuadri ligjor

1. Rregullore (BE) nr. 231/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 11 mars 2014 Për implementimin e Instrumentit për Asistencën e Para-Aderimit (IPA II);
2. Ligj nr. 37/2015 “Për ratifikimin e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II)”;
3. Vendim nr. 541, datë 18.06.2015 “Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësive dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve dhe strukturave të menaxhimit indirekt të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit IPA II (2014 – 2020);
4. Rregullore (BE) nr. 1529/2021 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 15 shtator 2021, për krijimin e Instrumentit për Asistencën e Para-Aderimit (IPA III);
5. Ligj nr. 65/2022 “Për ratifikimin e marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian për rregullat specifike të zbatimit të asistencës financiare të BE-së për Republikën e Shqipërisë në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA III)”;
6. Vendim nr. 540, datë 20.9.2023 për përcaktimin e funksioneve, përgjegjësive dhe marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve e strukturave për menaxhimin indirekt të asistencës financiare të Bashkimit Evropian nën Instrumentin për Asistencën e Paraanëtarësimit 2021–2027 (IPA III)
7. Ligj nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar;
8. Urdhër i Ministrit të Drejtësisë, Nr. 746, datë 29.12.2023 “ Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”;
9. Urdhër i Ministrit të Drejtësisë, Nr. 583, datë 06.10.2023 “Për miratimin e Rregullores për Koordinimin e Ndhmës së Huaj”

Projektet kryesore në Fushën e Drejtësisë që DPDFD monitoron janë përkatësisht:

1. Mbështetje për Zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë (JUSTAL) - financuar nga Bashkimi Evropian;
2. Menaxhimi i Integruar i Çështjeve Gjyqësore (ICMS) - financuar nga SIDA;
3. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit (IMO III) – financuar nga BE dhe ADA;
4. EU 4 Justice Albania - financuar nga Bashkimi Evropian;
5. Rritja e mbrojtjes së të drejtave të njeriut të të burgosurve në Shqipëri, faza I - financuar nga Bashkimi Evropian;
6. Rritja e bashkëpunimit në Ballkanin Perëndimor për menaxhimin e ekstremizmit të dhunshëm në burgje dhe parandalimin e radikalizimit të mëtejshëm pas lirimimit - financuar nga Bashkimi Evropian;
7. Zgjerimi dhe Forcimi i Sistemit të Ndërmjetësimit në Shqipëri – financuar nga ADA;
8. Zgjerimi i shërbimeve të ndihmës juridike falas për gratë dhe burrat në Shqipëri (EFLAS) – financuar nga ADA
9. Forcimi i Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut në Shqipëri - Fazat II – financuar nga OSBE;
10. Forcimi i të Drejtave të Njeriut në Shqipëri - Faza II - financuar nga OSBE;
11. Burgje të sigurta - Komunitete të sigurta – financuar nga Ministria e Puneve te Jashtme Hollandeze.

Donatorët, me të cilët Drejtoria e Projekteve në Fushën e Drejtësisë kryesisht bashkëpunon janë, përkatësisht si më poshtë:

1. Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA);
2. Ambasada e Mbretërisë së Holandës;
3. Ambasada Franceze;
4. Banka Botërore;
5. Bashkimi Evropian;
6. Byroja Ndërkombëtare e Narkotikëve dhe Çështjeve të Ligjit dhe Zbatimit SHBA;
7. Franca;
8. Gjermania;
9. Italia;
10. Këshilli i Evropës;
11. Mbretëri e Bashkuar;
12. Ministria e Punëve të Jashtme Hollandeze;
13. Norvegjia;
14. OSBE;
15. Sllovakia;
16. Suedia.